

# Programi i kopshtit parashkollor

**Qëllimi i kopshtit grek është «të ndihmojë parashkollorët të zhvillohen fizikisht, emocionalisht, psikologjikisht dhe shoqërisht». (Ligji 2327/95, Gazeta Zyrtare 165 A´)**

Informohem  
rreth arsimit

Kopshti i sotëm parashkollor ndryshon shumë nga ai që njohim ne prindërit dhe si rezultat krijohen shumë paqartësi tek të gjithë ata që kanë fëmijë që ndjekin kopshtin. Gjithashtu mund të ndryshojë edhe nga kopshtet që njohin prindërit të cilët vijnë nga vende të tjera, ose që kanë ndjekur kopshtin në sisteme të ndryshëm shkollorë.

## **Ndryshimet që vëmë re në programin e kopshtit modern shkaktohen nga arsye të tjera:**

- Nga studimet që na shpjegojnë si mësojnë më mirë njerëzit në mosha të ndryshme.
- Nga nevoja të parapregatitimit fëmijët dhe qytetarët e së nesërme për një botë që ndryshon me ritme të shpejta.
- Nga nevoja t'u japim fëmijëve jo kaq dije (p.sh. a keni menduar ndonjëherë sa vende ekzistojnë në hartë kur shkonim në shkollë dhe sa janë sot?) sesa aftësi që do t'i ndihmojnë të përballojnë ndryshimet shoqërore, ekonomike dhe

## **Sot, pra, përderisa fëmijët tuaj ndjekin kopshtin publik mund t'i shikoni të:**

- «Ndërtojnë» me «tulla» objekte të mëdha apo të vogla që u japin shansin të klasifikojnë forma dhe madhësi, të përdorin fantazinë e tyre, të kontrollojnë dorën dhe lëvizjet delikate të gishtave, të koordinojnë sytë me duart, etj.

- Të krijojnë «skenarë» të frymëzuar nga jeta e përditshme e tyre, fantazia e tyre dhe të luajnë role (mamin, babin, shoferin e autobuzit, postierin). Kjo lojë ndihmon fëmijët të zhvillojnë të folurën e tyre, të shprehin ndjenjat e tyre dhe të mësojnë të bashkëpunojnë.

- Të huazojnë libra nga biblioteka e klasës që t'i lexoni bashkë me ta në shtëpi në fundjavë.

- Të bashkëpunojnë në grupe të mëdha e të vogla, për ndërtimin e një objekti ose të zgjidhin një problem (p.sh. çfarë mund të bëjmë për ngjyrat që ngelën pa kapakë?)



- Të vëzhgojnë kohën, lulet e klasës, insektet e oborrit dhe në përgjithësi botën rreth tyre dhe të rregjistrojnë vërejtjet e tyre ku mund të shikojnë evoluimin apo ndryshimin që ndodh.

- Të kërkojnë ndihmën tuaj që të gjeni informacione nga interneti ose të bëni diçka bashkë.

- Të vizitojnë me mësuesin/en muze, teatre, monumente të qytetit ose të lagjes së tyre dhe të ftojnë «specialistë» në klasë që t'i pyesin dhe të mësojnë gjëra të reja (p.sh. dentistin ose postierin e lagjes).



## **Gjithashtu në kopshtin parashkollor fëmijët inkurajohen midis të tjerash:**

- Të studiojnë tema që u interesojnë (p.sh. kafshët, makineritë, lojrat etj.).

- Të tregojnë histori nga jeta e tyre ose nga fantazia e tyre.

- Të marrin «intervista» nga bashkëmoshatarë apo të rritur, (psh. Anëtarë të familjes së tyre), që të mësojnë me çfarë lodrash luanin të vegjël, si jetonin, si argëtoheshin në familje të ndryshme etj.

- Të shkruajnë si të munden dhe për arsye që kanë kuptim për ata vetë (p.sh. Pse duan t'i shkruajnë një letër një anëtar të familjes së tyre? Pse duan t'u dërgojnë një ftesë fëmijëve të klasës tjetër për festën? etj.).

- Të përdorin numërimin në rrethana të ndryshme (p.sh. të numërojnë fëmijët e klasës që të gjejnë kush mungon, të llogaritin sa ditë mbeten akoma deri për pushimet e Pashkës), të ndajnë midis tyre në mënyrë të barabartë sasi të ndryshme, të njohin forma gjeometrike në ambient, të përdorin vegla të ndryshme që të gjejnë gjatësinë e tyre ose gjatësinë e objekteve, etj.



- Të marrin role përgjegjëse me qëllim funksionin e mirë të klasës (p.sh. grupe pune, të mbledhin lodrat e tyre, etj.).
- Të vendosin vetë për temat që kanë të bëjnë me ta (p.sh. si mund të zgjidhin kontradiktat që kanë midis tyre, çfarë mund të bëjnë për një libër që u gris, etj.).
- Të bëjnë ata vetë rregullat e grupit të tyre dhe të marrin përsipër që t'i rikujtojnë tek të tjerët.
- Të bëjnë pyetje, të ngrenë çështje dhe të kërkojnë vetë përgjigjen («çfarë mund të bëjmë që të rritet lulja e klasës?»).
- Të marrin pjesë në eksperimente që të njihen me kuptime të shkencave natyrore (p.sh. objektet dhe cilësitë e tyre, ndryshimin e ditës dhe të natës, etj.).
- Të përdorin kompjuterin, ose të shkruajnë, ose të luajnë lojra edukative.
- Të mësojnë për kultura dhe vende të tjera, ose me ndihmën e shokëve të grupit, ose nëpërmjet aktiviteteve të posaçme.



*Enti zbatues*

**POLIDHROMOS: Grupi dhe Botimi periodik për Dygjuhësinë dhe Shumëkulturën në Arsim dhe në Shoqëri**



*Autore teksti*

**Andhromahi Zafiriadu**, Edukatore parashkollore  
**Maria Birbili**, Departamenti i Shkencave të Edukimit  
dhe të Arsimit Parashkollor

*Koordinatorë të programit*

**Birbili Maria – Cokalidhu Rula**  
Departamenti i Shkencave të Edukimit  
dhe të Arsimit Parashkollor  
Universiteti Aristoteli Selanik

**Email:** mmpirmpi@nured.auth.gr  
tsokalid@nured.auth.gr

**Website:** [www.polydromo.gr/dialogos](http://www.polydromo.gr/dialogos)

*Përkthyes*

**Valbona Hystuna**

*Përpunuan tekstin*

**Evi Marku**

**Me mbështetjen e**

